




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Komuna e Gjakovës - Komisioni i themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me numër 01nr.011/01-29518, datës 30.07.2019, duke u bazuar ne nenin 8 paragrafi 1 pika 1.1 dhe neni 15 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujtëshme të Komunës, nenit 14 të rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës me qellim të zbatimit të vendimit paraprak me numër 01 Nr.011-78400 të datës 02.11.2015 të miratuar nga Kuvendi Komunal për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale “Tregu në Orize”, me datën 19.03.2021 rishpallë këtë:

NJOFTIM PUBLIK

Për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme Komunale-Tregu në Orize

Ftohen të gjithë të interesuarit personat fizik dhe juridik që të aplikojnë për marrjen në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme të Komunës në afat kohor:

- Prej 1 viti, “Tregu në Orize”

Njësia me numër kadastrale : pjesë e parcelave nr.5127-3 në sipërfaqe prej 1100m²

Qëllimi:

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të përkohshëm është:

- Të krijohet një ambient i përshtatshëm për shitësit dhe qytetarë;
- Përfitimi ekonomik i komunës përmes qiradhënies.

Kushtet për Pjesëmarrje:

1. Deklarata nën betim;
2. Vërtetimi i ATK, origjinali;
3. Vërtetimin e tatimit në pronë.

Përshtatshmëria profesionale:


1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
2. Certifikatën e TVSH ose (TM-1- TM-4 te vitit të fundit fiskal);
3. Letër Referencë për punë të ngjashme.

Kushtet e veçanta :

1. Përzgjedhja e fituesit bëhet në bazë të çmimit më të lartë të ofruar si dhe kritereve të përcaktuara në këtë njoftim publik;
2. Çmimi fillestar i qirasë mujore është 600€;
3. Pagesat e të gjitha komunalive që ndërlidhen me tregun nga nënshkrimi i kontratës i bartë përfituesi-shfrytëzuesi;
4. Orari i punës të jetë sipas rregullores komunale në fuqi;
5. Organizimi brenda lokacionit të tregut të bëhet sipas projektit të cilin fituesi i ankandit do ta marrë nga DSHP.

Vërejtje: Dosjet të cilat nuk janë të kompletuara sipas kushteve të përcaktuara në këtë njoftim nuk do të shqyrtohen, do të konsiderohen si të pavlefshme.

- 1) **Vendi dhe koha ku do të mbahet ankandi publik:** Me datën 02.04.2021 në ora 15-00 në objektin e Komunës, Rruga “UÇK” (ish objekti i Bankosit), kati IV, salla e asamblesë komunale.
 - 2) **Vlerësimi i ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës:** pas miratimit të ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues, njoftimi i dërgohet fituesit dhe i njëjti publikohet në ueb – faqen e Komunës. Pala e pakënaqur me vlerësimin e komisionit, ka të drejtë të parashtojë ankesë pranë “ *Komisionit për ankesa*” në afat prej shtatë (7) ditësh pas shpalljes së njoftimit në ueb – faqen e Komunës së Gjakovës.
- Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale, nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe fituesi i zgjedhur, pas rekomandimit nga komisioni.
- 3) **Periudha e vlefshmërisë së njoftimit publik do të jetë 15 ditë kalendarike, nga data 19.03.2021 deri me 02.04.2021.**
 - 4) **Ofertat me dokumentacionin e plotësuar, duhet të dorëzohen në Komunën e Gjakovës, në Zyrën e Pranimi në katin përdhese , 1 origjinal dhe 2 kopje, adresa: rruga “UÇK”, Nr. 53, 50000 Gjakovë.**

 Kryesues i Komisionit

Shkumbin Kastrati